



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.16

27 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.114, datë 27.1.12009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet e impiantet, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre	1083
Vendim i KM nr.116, datë 2.2.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/10 kv, në qytetin e Bajram Currit	1085
Vendim i KM nr.117, datë 2.2.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.....	1087
Vendim i KM nr.118, datë 2.2.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.83, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash (pjesa e dytë)”.....	1092
Vendim i KM nr.119, datë 2.2.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.268, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash (pjesa e tretë)”.....	1094
Vendim i KM nr.121, datë 2.2.2009	Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në fushën industriale	1096
Vendim i KM nr.122, datë 2.2.2009	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore	1107

Vendim i KM nr.126, datë 2.2.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pogon të qarkut të Gjirokastrës	1112
Vendim i KM nr.127, datë 2.2.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Maliq të qarkut të Korçës	1113
Vendim i KM nr.128, datë 2.2.22009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	1115
Kërkesë e MPPTT nr.1008, datë 12.2.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe drufrutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.....	1116
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Muka dhe caktimin e kujdestarisë së pasurive të tij.....	1122

VENDIM
Nr.114, datë 27.1.12009

PËR MARRJEN E MASAVE EMERGJENTE, PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS SË SIGURISË DHE TË VEPRIMTARIVE NË INSTALIMET E IMPIANTET, QË SHËRBEJNË PËR DEPOZITIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Në mbështetje të neneve 59, pika 1 shkronja “d”, e 100, të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.9322, datë 25.11.2004 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 1, 2 e 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e grupit të punës për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë, në impiantet dhe instalimet, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, i cili të drejtohet, bashkërisht, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e ku të bëjnë pjesë zëvendësministrat e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe drejtuesit e Inspektoratit Qendror Teknik (IQT), Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK), agjencive rajonale të mjedisit (ARM) dhe drejtorive për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin (PMNZSH).

2. Grupi i punës ka për detyrë të realizojë:

a) Kontrollin dhe verifikimin e respektimit të kushteve teknike të ndërtimit dhe funksionimit të të gjitha impianteve e instalimeve, ku kryhet veprimtaria e depozitimit, transportimit dhe tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për të përcaktuar nivelin e sigurisë.

b) Brenda 2 (dy) muajve, listën e subjekteve, që kryejnë veprimtarinë e depozitimit, transportimit dhe tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, pa lejet përkatëse, ose listën e subjekteve, veprimtaria e të cilave paraqet rrezik për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit, sepse ndodhen brenda territorit të zonave të banuara dhe t’ia paraqesë Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

c) Listën për subjektet e tjera, jashtë zonave të banuara, që e ushtrojnë veprimtarinë pa lejet përkatëse ose që veprimtaria e tyre paraqet rrezik për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit dhe t’i paraqesë, brenda 3(tre) muajve, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Afatet e përcaktuara në shkronjat “b” e “c” të pikës 1 të këtij vendimi fillojnë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të vendimit.

3. Veprimtaritë e depozitimit, transportimit ose tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në impiante dhe instalime të ndërtuara në rrugët dhe në mjedise urbane (brenda qyteteve ose zonave të banuara), të cilat zhvillohen edhe pa lejet përkatëse, dhënë sipas legjislacionit në fuqi, dhe paraqesin rrezikshmëri për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, të prishen ose të mbyllen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i bashkisë/komunës apo nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në përputhje me ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Policisë së Shtetit.

4. Veprimtaritë e depozitimit, transportimit ose tregtimit, me shumicë ose pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në impiantet dhe instalimet e ndërtuara jashtë qyteteve ose jashtë zonave të banuara, që zhvillohen pa lejet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, por rezultojnë se plotësojnë kushtet teknike dhe të sigurisë, bllokohen nga IQT-ja, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës apo Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Policisë së Shtetit.

Subjekti përkatës, brenda 3 muajve pas realizimit të kontrollit, sipas afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të bëjë plotësimin e dokumentacionit, në përputhje me kërkesat e

legjislacionit në fuqi.

5. Veprimtaritë e depozitimit, transportimit dhe tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në impiante dhe instalime, të cilat ushtrohen nga subjekte të pajisura me lejet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, por që veprimtaria e tyre cilësohet se paraqet rrezikshmëri për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, të mbyllën ose të prishen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe Policia e Shtetit.

6. Shpenzimet për mbylljen ose prishjen fizike të impianteve dhe instalimeve, që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të depozitimit, transportimit ose tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas pikave 2, 3 e 4 të këtij vendimi, bëhen me shpenzimet e vetë subjekteve.

7. Ndalohet futja nga importi, në formë skrapit, i bombolave, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e gazit të lëngshëm të naftës (GLN).

Bombolat, që nuk plotësojnë standardet e sigurisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8739, datë 12.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion”, konfiskohen nga IQT-ja.

8. Vërtetimi për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, i lëshuar nga IQT-ja, për marrjen e lejeve përkatëse për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, rinovohet çdo vit.

Tarifa për këtë shërbim përcaktohet me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave.

9. Ndalohet tregtimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nga subjekte, që kryejnë veprimtarinë e depozitimit, transportimit ose tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari të depozitimit, transportimit ose tregtimit me pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të cilat nuk janë pajisur me lejet apo autorizimin përkatës, në përputhje e kërkesat e legjislacionit në fuqi për ushtrimin e këtyre veprimtarive.

10. Në rast të mosrespektimit të kësaj kërkesë, nga subjektet e tregtimit me shumicë, të përmendura më sipër, IQT-ja pezullon të drejtat e lejes së tregtimit dhe i propozon organit përkatës revokimin e lejes.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.116, datë 2.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/10 KV, NË QYTETIN E BAJRAM CURRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private,

për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/10 KV, në qytetin e Bajram Currit, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të OSSH sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2 952 (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) m², tokë/truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme 13 360 752 (trembëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

4. Fondi prej 13 360 752 (trembëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh të përballohet nga fondet e OSSH sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 233 000 (dyqind e tridhjetë e tre mijë) lekë, të përballohet po nga OSSH sh.a., si subjekt përfitues.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit shkurt 2009 dhe të përfundojë brenda muajit prill 2009.

7. Pagesat të bëhen pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999.

8. Punimet për ndërtimin e nënstacionit 110/10 KV të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2009.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OSSH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110/10 KV, BAJRAM CURRI

Rrethi: Tropojë

Bashkia: Bajram Curri

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: truall

Shpronësimi definitiv												Adresa e pronarit
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sipërfaqja totale në m ²	Sipërfaqja që shpronësohet në m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Vlera totale e shpronësimit në lekë	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Aranit	Çel	Gjongecaj	Truall	1347	43/14/1	2952	2952	4 526	13 360 752	13 360 752	Lagjja “Dardania”, Bajram Curri, Tropojë
2	Durim	Çel	Gjongecaj				2952	2952	4 526	13 360 752	13 360 752	Lagjja “Dardania”, Bajram Curri, Tropojë

VENDIM
Nr.117, datë 2.2.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.11.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 111 988 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) m² tokë/arë, me çmimin 650 (gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë/m², me vlerë 72 792 200 (shtatëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë, për sipërfaqen 7160 (shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) m², tokë/truall, me çmimin 1500 (një mijë e pesëqind) lekë/m², me vlerë 10 740 000 (dhjetë milionë e shtatëqind e dyzet mijë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 83 532 200 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 83 532 200 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.1.2009 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

7. Pronarët e shënuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuidojë pronarët e shënuar në listë, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE QE PREKEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN - KALIMASH

Nr.	Pronari			Z.K.	Nr. Pas	Sip. Totale	Toke are			Toke truall			Vlera Totale leke	Fshati	Shenime
	Emeri	Atesia	Mbiemri				Sip.m2	Cmimi leke/m2	Vlera leke	Sip. m2	Cmimi leke/m2	Vlera leke			
1	Aleksander	Zef	Brunga	2769	73/4	33200	13244	650	8608600				8608600	Nderfushaz	Konfirmuar nga ZRPP
2	Nikolin	Llesh	Gjoka	2769	16/2	8625	991	650	644150				644150	Ndrefushaz	Konfirmuar nga ZRPP
3	Ndue	Llesh	Gjoka	2769	16/6	3023	914	650	594100				594100	Ndrefushaz	Konfirmuar nga ZRPP
4	Illir	Gjok	Ndreca	2610	165/5	108				108	1500	162000	162000	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
5	Nikoll	Llesh	Ndreca	2610	165/3	95	95	650	61750				61750	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
6	Ndue	Bibe	Tuci	2610	228	2415	1940	650	1261000				1261000	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
7	Zef	Mark	Nikolli	2610	38	412	412	650	267800				267800	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
8	Simon	Mark	Nikolli	2610	36	354	354	650	230100				230100	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
9	Mark	Shkurt	Nikolli	2610	40	327	327	650	212550				212550	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
10	Mhill	Mark	Nikolli	2610	35	347	347	650	225550				225550	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
11	Ndue	Bibe	Tuci	2610	177	71	71	650	46150				46150	Mashterkore	Konfirmuar nga ZRPP
12	Dedin	Preng	Kola	1893	414/8	500	500	650	325000				325000	Guri Bardhe	Konfirmuar nga ZRPP
13	Gjergj	Zef	Shyti	1893	414/9	1359	709	650	460850				460850	Guri Bardhe	Konfirmuar nga ZRPP
14	Pjeter	Zef	Kaza	1893	414/6	1600	1600	650	1040000				1040000	Guri Bardhe	Konfirmuar nga ZRPP
15	Ndue	Dod	Kaza	1893	414/13	675	375	650	243750				243750	Guri Bardhe	Konfirmuar nga ZRPP
16	Pjeter	Zef	Shyti	1893	414/4	1358	176	650	114400				114400	Guri Bardhe	Konfirmuar nga ZRPP
17	Leonard	Gjon	Nikolli	1896	414/2	1400	51	650	33150				33150	Guri Bardhe	Konfirmuar nga ZRPP
18	Gjet	Dod	Nikolli	3433	60/4	2000	1325	650	861250				861250	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
19	Ded	Dod	Nikolli	3433	60/3	1000	184	650	119600				119600	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
20	Ndue	Zef	Zefi	3433	45/1	550	550	650	357500				357500	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
21	Agustin	Zef	Marku	3433	43/1	1200	300	650	195000	134	1500	201000	396000	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
22	Preng	Dod	Nikolli	3433	59/8	200				116	1500	174000	174000	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP

23	Fran	Ndue	Cera	3433	6	1600	302	650	196300				196300	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
24	Fran	Ndue	Cera	3433	7/2	18710	15329	650	9963850				9963850	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
25	Fran	Gjon	Pjetri	3433	56/1	145	145	650	94250				94250	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
26	Bardhok	Pjeter	Pjetri	3433	56/2	280	280	650	182000				182000	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
27	Ndue	Gjon	Pjetri	3433	7/4	6950	1834	650	1192100				1192100	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
28	Fran	Gjon	Pjetri	3433	54/2	812	512	650	332800	300	1500	450000	782800	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
29	Mark	Preng	Gjoka	3433	42/2	550	550	650	357500				357500	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZRPP
30	Mirash	Ndue	Pershqefa	1190	48	1300				773	1500	1159500	1159500	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
31	Ndue	Mark	Gjoka	1190	53	250	250	650	162500				162500	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
32	Ndue	Mark	Gjoka	1191	55	700	700	650	455000				455000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
33	Ndue	Zef	Pershqefa	1190	46	850	850	650	552500				552500	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
34	Preng	Dod	Prenga	1190	4/2	1300	500	650	325000	380	1500	570000	895000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
35	Gjet	Nikoll	Pershqefa	1190	60	600	300	650	195000	300	1500	450000	645000	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
36	Kin	Zef	Prenga	1190	3/2	1400	796	650	517400	500	1500	750000	1267400	Bisak	Konfirmuar nga ZRPP
37	Dritan	Ndue	Gjoka	1600	10/6	4395	2217	650	1441050				1441050	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
38	Pashk	Zef	Gjoka	1601	10/5	1480	1480	650	962000				962000	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
39	Mark	Preng	Gjoka	1600	10/3	4141	2129	650	1383850				1383850	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
40	Pashk	Zef	Gjoka	1600	10/7	1795	50	650	32500				32500	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
41	Preng	Ndue	Kola	1600	10/1	4235	4235	650	2752750				2752750	Fan	Konfirmuar nga ZRPP
42	Mark	Ndue	Gjoka	2162	70	500	200	650	130000	300	1500	450000	580000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
43	Mark	Ndue	Gjoka	2162	66/1	3250	2726	650	1771900				1771900	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
44	Gjovalin	Mark	Prenga	2162	87/9	250				250	1500	375000	375000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
45	Gjovalin	Mark	Prenga	2162	94	500	345	650	224250				224250	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
46	Preng	Mark	Mena	2162	84/8	800	800	650	520000				520000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
47	Pjeter	Ndue	Tuci	2162	88/2	300				300	1500	450000	450000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
48	Pjeter	Ndue	Tuci	2163	88/8	600	186	650	120900				120900	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
49	Gjon	Ndrec	Lleshi	2162	97	950	950	650	617500				617500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
50	Preng	Pjeter	Marku	2162	99/2	2250	1895	650	1231750				1231750	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
51	Frrok	Pal	Margjeci	2162	102	350	350	650	227500				227500	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
52	Mare	Gjon	Gjoka	2162	66/2	2260	921	650	598650				598650	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
53	Kol , Dava	Ndue	Lleshi	2162	88/6	300				238	1500	357000	357000	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
54	Preng	Ndue	Deda	3883	59	2300	758	650	492700				492700	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP

55	Dava	Zef	Qafa	3883	20	2750	1993	650	1295450				1295450	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
56	Mark	Kol	Biba	3883	11/2	500				500	1500	750000	750000	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
57	Dava	Ded	Gjaci	3883	186	300				300	1500	450000	450000	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
58	Gjon	Ndue	Deda	3883	56	3050	335	650	217750				217750	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
59	Gjon	Ndue	Deda	3883	54	1800	1380	650	897000				897000	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
60	Preng	Ndue	Deda	3883	59	2300	758	650	492700				492700	Zall-Xhuxhe	Konfirmuar nga ZRPP
61	Zef	Ndue	Ndreca	3883	21/7	612	612	650	397800				397800	Z-Xh	Konfirmuar nga ZRPP
62	Zef	Preng	Doda	3259	125	2920	1673	650	1087450				1087450	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
63	Fran	Zef	Doda	3259	108/3	1300	323	650	209950				209950	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
64	Gjet	Vokerr	Nikolli	3259	114	2565	2565	650	1667250				1667250	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
65	Nikolin	Gjon	Nikolli	3259	115	2333	236	650	153400				153400	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
66	Ndue	Preng	Prenga	3259	105	1400	1100	650	715000	233	1500	349500	1064500	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
67	Ded	Nikoll	Prenga	3259	103/2	600	500	650	325000				325000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
68	Ndue	Gjok	Doda	3259	120/2	2111	1540	650	1001000				1001000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
69	Ndue	Vorf	Loka	3259	149/1	2571	2571	650	1671150				1671150	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
70	Marie	Preng	Nikolli	3259	123/2	1600	1402	650	911300				911300	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
71	Frrok	Preng	Loka	3259	150	728	728	650	473200				473200	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
72	Ndue	Mark	Loka	3259	148	1507	1063	650	690950				690950	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
73	Marte	Ndrec	Lleshi	3259	152	860	629	650	408850				408850	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
74	Mark	Ndue	Lleshi	3259	157	2070	818	650	531700				531700	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
75	Ndue	Vorf	Loka	3259	149/2	1531	240	650	156000				156000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
76	Ndue	Vorf	Loka	3259	200	300				220	1500	330000	330000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
77	Frrok	Kol	Frroku	3259	118	2572	1409	650	915850				915850	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
78	Ndrec	Preng	Frroku	3259	117	3409	1960	650	1274000				1274000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
79	Ded	Ndue	Ndoj	3259	161	300				151	1500	226500	226500	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
80	Gjok	Ndue	Ndoj	3259	162	300				257	1500	385500	385500	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
81	Nikoll	Ndue	Ndoj	3259	189	300				300	1500	450000	450000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
82	Preng	Pjeter	Prenga	3259	113	6050	3236	650	2103400	500	1500	750000	2853400	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
83	Fran	Ndue	Lleshi	3259	155/1	400	400	650	260000				260000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
84	Fran	Ndue	Lleshi	3259	155/2	320	320	650	208000				208000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
85	Ndue	Zef	Lleshi	3259	139	1000	680	650	442000				442000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP
86	Mark	Ndue	Lleshi	3259	141	600	600	650	390000				390000	Sang	Konfirmuar nga ZRPP

87	Gjon	Zef	Pjetri	3598	76/1	6060	774	650	503100				503100	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
88	Valentin	Gjin	Pjetri	3598	26/4	500				500	1500	750000	750000	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
89	Llesh	Gjergj	Pjetri	3598	127/1	3300	2004	650	1302600	500	1500	750000	2052600	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
90	Bardhok	Ndue	Prendi	1221	75/3	1201	578	650	375700				375700	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
91	Anton	Gjin	Prendi	1221	75/2	1131	307	650	199550				199550	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
92	Bardhok	Gjergj	Prendi	1221	81/2	861	861	650	559650				559650	Blinisht	Konfirmuar nga ZRPP
93	Pashk	Ndue	Marku	2933	151	600	69	650	44850				44850	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
94	Luigj	Ndue	Marku	2933	152/2	2250	1217	650	791050				791050	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
95	Pashke	Ndue	Marku	2933	152/4	1829	1381	650	897650				897650	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
96	Gjovalin	Llesh	Marku	2933	152/8	4146	2246	650	1459900				1459900	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
97	Luigj	Ndue	Marku	2933	159	2700	753	650	489450				489450	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
98	Frrok	Dod	Shqefni	2933	152/10	1258	750	650	487500				487500	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
99	Fran	Ndue	Gjeta	2933	152/11	1806	1143	650	742950				742950	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
100	Fran	Nikoll	Shqefin	2933	157/3	2182	1740	650	1131000				1131000	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
101	Pashke	Ndue	Marku	2933	157/4	2308	1948	650	1266200				1266200	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
102	Pashke	Ndue	Marku	2933	158	1100	359	650	233350				233350	Pshqesh	Konfirmuar nga ZRPP
103	Nikoll	Gjok	Nikolli	1713	146/14	4162	732	650	475800				475800	Geziq	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI					111988		72792200	7160		10740000	83532200		

VENDIM
Nr.118, datë 2.2.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.83, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH (PJESA E DYTË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.83, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Sipërfaqja 162 397 m², tokë/arë, bëhet 161 348 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) m².

b) Vlerësimi 105 558 050 (njëqind e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëdhjetë) lekë, për sipërfaqen tokë/arë, bëhet 104 876 200 (njëqind e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë.

c) Sipërfaqja 10 368 m², tokë/truall, bëhet 11 417 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) m².

ç) Vlerësimi 15 552 000 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, për sipërfaqen tokë/truall, bëhet 17 125 500 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e pesëqind) lekë.

d) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 121 110 050 (njëqind e njëzet e një milionë e njëqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë bëhet 122 001 700 (njëqind e njëzet e dy milionë e një mijë e shtatëqind) lekë.

2. Pronarët të kompensohen për diferencën e konvertimit në truall të sipërfaqes së shpronësuar sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Totali i diferencës së konvertimit, prej 891 650 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

4. Likuidimi të fillojë më 30.1.2009 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

5. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen për diferencën përkatëse të konvertimit të tokës në truall, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA KORRIDORI DURRËS-MORINË (SEKSIONI RRËSHEN-KALIMASH)
Lloji i pasurisë së patundshme: tokë truall

Nr.	Pronari				VKM nr.83,datë 3.2.2008								Ndryshimi sipas ZRPP-së				Diferenca e llogaritur për likuidim	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.pas	Sip.m ² arë	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.pas	Sip m ² truall	Çmimi m2	Vlera/ lekë		
	Fshati Mashterkor																	
1	Vasil	Gjok	Ndreca	2610	237	236	650	153400	Vasil	Gjok	Ndreca	2610	237	236	1500	354 000	200 600	Konfirmuar nga ZRPP
2	Anton	Nikoll	Ndreca	2610	236	313	650	203450	Anton	Nikoll	Ndreca	2610	236	313	1500	469 500	266 050	Konfirmuar nga ZRPP
3	Eridon	Fran	Skana	2610	214/1	500	650	325000	Eridon	Fran	Skana	2610	214/1	500	1500	750 000	425 000	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali				1049		681850						1049		1573500	891650	

VENDIM
Nr.119, datë 2.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.268, DATË 5.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH (PJESA E TRETË)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.268, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

- a) Sipërfaqja 58 570 m², tokë/arë bëhet 58 070 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë) m².
- b) Vlera e kompensimit, për sipërfaqen tokë/arë, nga 38 070 500 (tridhjetë e tetë milionë e shtatëdhjetë mijë e pesëqind) lekë bëhet 37 745 500 (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) lekë.
- c) Sipërfaqja 8 859,5 m², tokë/truall bëhet 9 359,5 (nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë presje pesë) m².
- ç) Vlera e kompensimit, për sipërfaqen tokë/truall, 13 289 250 (trembëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë bëhet 14 039 250 (katërmëdhjetë milionë e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
- d) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 51 359 750 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë bëhet 51 784 750 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

2. Pronari të kompensohet për diferencën e konvertimit në truall, të sipërfaqes së shpronësuar, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Totali i diferencës së konvertimit, prej 425 000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

4. Likuidimi të fillojë më 30.1.2009 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

5. Pronari i shënuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet për diferencën përkatëse të konvertimit nga tokë/arë në tokë/truall, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarit brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA KORRIDORI DURRËS-MORINË (SEKSIONI RRËSHEN-KALIMASH)

Lloji i pasurisë së patundshme: tokë truall

Nr.	Emri	Pronari		ZK	VKM nr.268, datë 5.3.2008					Pronari			ZK	Ndryshimi sipas ZRPP-së					Shënime
		Atësia	Mbiemri		Nr.pas	Sip.shpronësuar	Arë kthyer në truall	Çmimi m ²	Vlera lekë	Emri	Atësia	Mbiemri		Nr.pas	Sip m ² truall	Çmimi m ²	Vlera lekë	Diferenca e llogaritur për likuidim	
	Fshati Sang																		
1	Anton	Preng	Prenga	3259	107	3650	500	650	325 000	Anton	Preng	Prenga	3259	107	500	1500	750 000	425 000	Konfirmuar nga ZRPP
			Totali				500		325000						500		750 000	425 000	

VENDIM
Nr.121, datë 2.2.2009

PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”
NË FUSHËN INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. OBJEKTI DHE QËLLIMI

1. Objekt i këtij vendimi është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për realizimin e prokurimeve të mallrave, punëve dhe të shërbimeve, që kanë lidhje me sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, në fushën industriale.

2. Ky vendim ka si qëllim plotësimin e standardeve për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në fushën industriale, përcaktimin e kritereve të kontratave të klasifikuara, garancinë, që çdo kontraktues ka aftësinë dhe mundësinë të mbrojtë, në mënyrë të përshtatshme, informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

3. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

a) “Kontratë e klasifikuar”, çdo kontratë, që përmban informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

b) “Material i klasifikuar”, dokumentet dhe makineritë ose pajisjet, armatimi, komponentët e tyre, të prodhuara ose në proces prodhimi, të klasifikuara të tilla sipas legjislacionit.

c) “Autoriteti kontraktor”, subjektet shtetërore, që ndërmarrin një kontratë të klasifikuar.

ç) “Operatorë ekonomikë”, çdo person, fizik ose juridik ose çdo grup personash të tillë, që ofrojnë në treg furnizimin me mallra, punime dhe/ose shërbime.

d) “Ofertues”, çdo operator ekonomik, që ka paraqitur një ofertë, në mbështetje të dokumentacionit të tenderit të klasifikuar.

dh) “Pyetësi i sigurisë industriale”, tërësia e kërkesave, në bazë të të cilave gjykohet nëse një operator ekonomik plotëson kriteret për t’u pajisur me certifikatën e sigurimit industrial.

e) “Certifikata e sigurimit industrial”, dokumenti zyrtar i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik plotëson të gjitha standardet e përcaktuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, sipas nivelit dhe afateve të caktuara në kontratën përkatëse.

ë) “Instruksioni i sigurisë së projektit”, tërësia e rregullave dhe procedurave të sigurisë, të detyrueshme, për t’u zbatuar në projektin specifik të kontratës të klasifikuar.

f) “Plani i sigurisë së ngarkesës”, dokumenti i miratuar nga autoriteti kontraktor, ku përfshihen masat, që garantojnë sigurinë e transportit të materialit të klasifikuar.

g) “Vizitat”, të cilat bëhen në kuadër të detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, pas një kërkesë nga autoriteti kompetent i njëres palë ose në bazë të një ftese, nga autoriteti kontraktor.

gj) “Vizitorë”, përfaqësuesit zyrtarë të një shteti apo organizate ndërkombëtare, që, në

bazë të detyrave zyrtare, kërkojnë të vizitojnë objektet e kontraktorit.

II. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Autoritetet kontraktore, të cilave, për nevoja të realizimit të detyrave, u duhet të hyjnë në marrëdhënie me operatorë ekonomikë, për realizimin e prokurimeve të mallrave, të punëve dhe të shërbimeve, që kanë lidhje me sigurinë kombëtare dhe përbëjnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, duhet t’u kërkojnë ofertuesve “Certifikatën e sigurimit industrial”.

2. Procedura për lëshimin e certifikatës së sigurimit industrial fillon pasi autoriteti kontraktor përkatës përcakton se kontrata do të jetë e klasifikuar.

Ofertuesit, për marrjen e certifikatës, duhet të plotësojnë këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Deklaratën, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- c) Deklaratën, sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- ç) Pyetësorin e sigurimit industrial (forma dhe modeli i pyetësit përcaktohen nga DSIK-ja).

3. Operatori ekonomik duhet të përmbushë çdo kërkesë të autoritetit kontraktor, që ka të bëjë me sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

Kur operatori ekonomik është institucion shtetëror, kërkesa për aplikim shoqërohet vetëm me pyetësorin e sigurimit industrial.

4. Certifikata e sigurimit industrial kërkohet edhe për kontratat e klasifikuara me nënkontraktorë, kur parashikohet nënshkrimi i një kontrate të tillë ose kur zbatimi i kontratës kërkon nënshkrimin e kontratave me nënkontraktorë.

5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) lëshon certifikatën e sigurimit industrial.

III. NEGOCIMI DHE KONTRATAT E KLASIFIKUARA

1. Kontrata e klasifikuar përcaktohet dhe negociohet nga autoriteti kontraktor i interesuar.

2. Lëshimi i certifikatës së sigurimit industrial bëhet pasi kryhet verifikimi i subjekteve, që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie me autoritetin kontraktor.

Autoriteti kontraktor kërkon dokumentacionin përkatës nga ofertuesit, për lidhjen e kontratës së klasifikuar dhe, pasi kryen verifikimin paraprak, i kërkon Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pajisjen e tyre me certifikatë të sigurimit industrial.

Afati për lëshimin e certifikatës së sigurimit industrial është deri në 3 muaj dhe fillon nga data e paraqitjes së kërkesës në DSIK.

3. Pas lëshimit të certifikatës së sigurimit industrial, në nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar, që do të përfshihet në kontratën e klasifikuar, autoriteti kontraktor shpërndan ftesat për pjesëmarrje të ofertuesve në procedurën për negocimin dhe kryen negociatat për përzgjedhjen e kontraktuesit.

Informacioni, që trajtohet gjatë negociatave, është i klasifikuar.

4. Autoriteti kontraktor krijon kushte sigurie në mjediset e tij, në mënyrë që ofertuesit të njihen me përmbajtjen e kontratës së klasifikuar, gjatë zhvillimit të negociatave dhe përzgjedhjes të kontraktuesit, në përputhje me legjislacionin për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

5. Çdo operatori ekonomik, i cili ftohet të marrë pjesë në negociata, në procedurën për negocimin dhe në përzgjedhjen e kontraktuesit, duhet të jetë i pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme, me përjashtim të rasteve kur fjala është për kontrata të klasifikuara në nivelin “I kufizuar”.

6. Operatori ekonomik është i detyruar të kthejë tek autoriteti kontraktor të gjithë informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” menjëherë ose, maksimumi, deri brenda 5 ditëve, në rastet:

- a) kur nuk ia pranojnë ofertën;
- b) e tërheqjes nga pjesëmarrja në negociata;

- c) kur nuk përzgjidhet si kontraktues;
- d) e zgjidhjes në mënyrë të parakohshme të kontratës.

7. Dokumentacioni i të gjitha takimeve përkatëse të procesit të negociatave për përzgjedhjen e kontraktuesit, si prezantime, protokolle, regjistrime etj., përfshirë të dhëna specifike për pjesëmarrësit, palët negociuese të pranishme, kohën dhe qëllimin e takimeve, do të ruhen, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

8. Autoriteti kontraktor njofton, me shkrim, operatorin ekonomik fitues dhe nënshkruan me të kontratën.

IV. KUSHTET E KONTRATËS

1. Kontraktuesi duhet të jetë i pajisur me certifikatë të sigurimit industrial dhe përgjigjet për të gjitha veprimtaritë e nënkontraktuesve dhe pajisjen e tyre me certifikatën e sigurimit industrial, të përshtatshme.

Kontraktuesi harton instruksionin e sigurisë së projektit dhe e miraton atë tek autoriteti kontraktor.

2. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi dhe nënkontraktuesi duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme, të cilat përfshihen në instruksionin e sigurisë së projektit.

a) Caktojnë një person përgjegjës për mbikëqyrjen dhe drejtimin e masave të sigurisë, në lidhje me kontratën e klasifikuar ose nënkontratën.

b) Mbajnë lidhje të vazhdueshme me personin përgjegjës të autoritetit kontraktor, që mbikëqyr zbatimin e kontratës së klasifikuar.

c) Nuk riprodhojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të siguruar ose gjeneruar në kontratën e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur lejohet nga kontrata ose me miratim të autoritetit kontraktor.

ç) I sigurojnë autoritetit kontraktor, kur u kërkohet, të gjithë informacionin, në lidhje me personat që do të njihen me informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

d) Kufizojnë përhapjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” vetëm sipas parimit “Nevojë për njohje”, në përputhje me zbatimin e kontratës së klasifikuar ose të nënkontratës.

dh) Mbajnë “Regjistrin e personave të certifikuar”, (aneksi 5), sipas modelit përcaktuar nga DSIK-ja, për personat që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, gjatë zbatimit të kontratës ose nënkontratës.

e) Marrin miratimin e autoritetit kontraktor për çdo ndryshim strukturor apo për çdo ndryshim të personelit, që lidhet me realizimin e kontratës apo të nënkontratës.

ë) Raportojnë tek autoriteti kontraktor për çdo cenim ose kërcënim të sigurisë, si dhe për çdo informacion, që ngre dyshime në besueshmërinë e një punonjësi, ndryshime, që mund të ndodhin në zotërimin, kontrollin ose menaxhimin e mjeteve, ndryshime, që cenojnë masat e sigurisë dhe statusin e sigurisë së kontratës.

f) Krijojnë, në çdo kohë, kushtet dhe lehtësitë për inspektime, të planifikuara ose jo, të përfaqësuesve të DSIK-së dhe autoritetit kontraktor, në lidhje me kontratën.

g) Vendosin çdo nënkontraktues nën detyrime sigurie, të njëjta me ato të zbatuara për kontraktuesin.

gj) Nuk përdorin, pa autorizim të veçantë, me shkrim, nga DSIK-ja, informacion të klasifikuar të NATO-s, shteteve ose organizatave të tjera ndërkombëtare, të siguruar në vijim të kontratës, përveçse për qëllime specifike të kontratës ose nënkontratës.

h) Ia kthen autoritetit kontraktor të gjithë informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” ose informacionin e klasifikuar të NATO-s, shteteve ose organizatave të tjera ndërkombëtare, të përfutur gjatë realizimit të kontratës.

Autoriteti kontraktor specifikon rastet e kthimit të këtij informacioni.

i) Sigurojnë që asgjësimi, shkatërrimi i materialit të klasifikuar është kryer dhe regjistruar

sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe në përputhje me procedurat e sigurisë së autoritetit kontraktor.

j) Krijojnë kushte dhe marrin masa për trajnimin e personelit, që merret me realizimin e kontratës, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

V. NËNKONTRATAT

1. Para lidhjes së kontratave të klasifikuara me nënkontraktues, kontraktuesi detyrohet që:

a) të marrë autorizimin e autoritetit kontraktor për realizimin e nënkontratës;

b) të nisë procedurat për pajisjen me certifikatë të sigurimit industrial për nënkontraktuesin.

Në negociatat për përzgjedhjen e nënkontraktuesit, të çfarëdo niveli, marrin pjesë përfaqësues të sigurisë së autoritetit kontraktues.

2. Për pajisjen me certifikatë të sigurimit industrial të nënkontraktuesit zbatohen të njëjtat procedura si për kontraktuesin.

3. Kontraktuesi mund të fillojë negociatat me nënkontraktuesin pas marrjes së konfirmimit, se nënkontraktuesi është pajisur me certifikatë të sigurimit industrial përshtatshëm.

4. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, të kaluar te nënkontraktuesi.

VI. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT

1. Procesi i verifikimit të operatorit ekonomik bëhet sipas pyetësorit të sigurimit industrial.

2. DSIK-ja u kërkon institucioneve përkatëse, që kanë lidhje me sigurimin kombëtar, me rendin kushtetues, rendin publik, me organet e drejtësisë, të prokurorisë dhe ministrive e institucioneve të tjera shtetërore, si dhe subjekteve private, kur e gjykon të nevojshme, verifikimin e operatorit ekonomik.

3. DSIK-ja i kthen përgjigje autoritetit kontraktor për pajisje me certifikatë të sigurimit industrial brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Në rast mosrespektimi të këtij afati, DSIK-ja njofton autoritetin kontraktor për arsyet e vonësës.

4. Deklarimi i informacioneve të rreme në pyetësorin e sigurimit industrial përbën arsye për moslëshimin e certifikatës së sigurimit industrial.

5. DSIK-ja, në rastet kur kontraktuesi është operator ekonomik i huaj, bashkëpunon me autoritetin e sigurimit kombëtar të vendit përkatës.

6. DSIK-ja, në përfundim të procedurës së verifikimit, kur e gjen të mbështetur në legjislacion, lëshon certifikatën e sigurimit industrial.

7. Në rast moslëshimi të certifikatës së sigurimit industrial, DSIK-ja vë në dijeni autoritetin kontraktor, të cilit i parashtrohen arsyet e mospranimit.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka të drejtën e ankimimit brenda 10 ditëve, te Kryeministri, vendimi i të cilit është përfundimtar.

8. Certifikata e sigurimit industrial lëshohet në nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar, që përmban kontrata e klasifikuar.

9. Certifikata e sigurimit industrial është e vlefshme për aq kohë sa duhet për realizimin e kontratës, por jo më shumë se 3 vjet. Në rastet kur kontrata e klasifikuar është mbi 3 vjet, procedura e verifikimit për pajisjen me certifikatë të sigurimit industrial rifillon.

VII. DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Operatorët ekonomikë detyrohen të japin informacion:

a) Për statusin ligjor të tyre;

b) Për strukturat dhe kapitalin;

c) Për trupën administrative, për punonjësit, që do të marrin pjesë në realizimin e

kontratës dhe supervizorët;

ç) Për sistemin e mbrojtjes dhe masat e sigurisë për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, që do t’i besohet gjatë realizimit të kontratës;

d) Për rastet nëse ka marrë pjesë, më parë, në realizimin e kontratave të klasifikuara, brenda ose jashtë vendit;

dh) Për punonjësit e autorizuar, që do të kenë të drejtë të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”;

e) Për personin ose personat përgjegjës, të autorizuar nga operatori ekonomik për marrjen e masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, gjatë të gjitha fazave të realizimit të kontratës.

VIII. TRANSPORTIMI

1. Transportimi i materialit të klasifikuar jashtë zonës së sigurisë ose jashtë shtetit kryhet me mjete, që plotësojnë kërkesat, për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, siç përcaktohet në kontratën e klasifikuar.

2. Autoriteti kontraktor përcakton masat për sigurimin e materialit të klasifikuar, që duhet të zbatohen në të gjitha etapat gjatë transportimit dhe në çfarëdo rrethanë, nga pika e origjinës deri në destinacion. Transportimi nga ajri dhe deti bëhen në të njëjtat kushte sigurie sikurse transportimi nga toka.

3. Masat për sigurimin e materialit të klasifikuar që transportohet duhet të jenë në nivelin më të lartë.

4. Personeli, që transporton materialin e klasifikuar, duhet të jetë i certifikuar përshtatshmërisht.

5. Itinerari i kalimit përcaktohet në rrugë të sigurta, por, nëse duhet të kalohet nëpër qytete të mëdha, merren masa, që materiali të jetë jashtë çdo kërcënimi dhe krize.

6. Paketimi i materialit të klasifikuar bëhet me listë inventari, sipas nivelit të klasifikimit.

7. Materiali i klasifikuar transportohet në arka metalike të mbyllura ose në kontenierë, të siguruar e nën mbikëqyrjen e një punonjësi sigurie, si dhe të markuara e të vulosura. Kur transporti përfshin dy ose më shumë kontenierë, masat e sigurisë për secilin duhet të merren në përputhje me nivelin më të lartë të klasifikimit të materialit të klasifikuar, që transportojnë.

8. Në rrethana të jashtëzakonshme, materiali i klasifikuar transportohet vetëm me mjete speciale, shoqëruar me rojë të armatosura, në bashkërendim me efektivat e Ministrisë së Brendshme ose të Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ndalimi në vende të caktuara gjatë transportimit bëhet në përputhje me një plan sigurie, të parapërgatitur.

10. Në raste emergjence, aksidenti, prishjeje automjeti, katastrofe natyrore apo të ngjashme me to, materiali i klasifikuar ruhet gjatë të gjithë kohës së ndalesës në vendin e caktuar, nga rojet e sigurimit, të armatosura, dhe nga personat shoqërues.

11. Gjatë transportimit të materialit të klasifikuar mbahet komunikim i vazhdueshëm, me mjete dhe pajisje të certifikuara përshtatshmërisht.

12. Në kushtet e rrezikut në rritje për materialin e klasifikuar caktohen roja të sigurisë.

Në varësi të vlerësimit të rrezikut konkret, mund të caktohen roje dhe civilë të armatosur.

Personat e ngarkuar si rojë ose si persona shoqërues trajnohen dhe u jepen instruksione të hollësishme se si ta trajtojnë materialin e klasifikuar.

IX. VIZITAT

1. Vizitat kryhen për qëllime të ligjshme dhe të autorizuar nga autoriteti kontraktor, kur parashikohet se materiali i klasifikuar do të paraqitet nga një kontraktues i certifikuar përshtatshmërisht.

2. Vizitat caktohen gjatë një periudhe njëvjeçare. Vizitat që lidhen me kontratën e klasifikuar kryhen për sa kohë zgjat kontrata dhe me miratimin e autoritetit kontraktor. Numri i vizitave duhet të jetë sa më i vogël. Vizitat kategorizohen:

a) Vizita të veçanta, me një qëllim të caktuar dhe kohëzgjatje deri në 30 ditë dhe që nuk përsëriten brenda vitit;

b) Vizita periodike, në periudha të caktuara kohore, brenda vitit;

c) Vizita urgjente, që kryhen për shkak të një çështjeje të një rëndësie të veçantë.

3. Vizitat kryhen tek autoriteti kontraktor ose te kontraktuesi. Në rastet kur subjekt i vizitave është kontraktuesi, ai njofton me shkrim autoritetin kontraktor dhe kërkon miratimin e tij për kryerjen e vizitës.

Në raste urgjente, kërkesa për vizitë mund të bëhet gojarisht, me kusht që të shoqërohet, më pas, me shkrim, brenda 10 ditëve nga data e kryerjes së vizitës.

4. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, në zbatim të detyrave zyrtare, mund të vizitojnë kontraktuesin pa lajmërim paraprak, me kusht që këta përfaqësues të paraqesin certifikatën e sigurisë dhe dokumentet e identifikimit të pozicionit zyrtar, si dhe autorizimin përkatës.

Në vizitat e miratuara më parë, që nuk lidhen me kontratën e klasifikuar, informacioni i klasifikuar “Sekret shtetëror” nuk ekspozohet pa miratimin paraprak të autoritetit kontraktor.

5. Vizitorëve u jepet akses vetëm për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, që lidhet me qëllimin e vizitës dhe me domosdoshmërinë e njohjes me informacionin, pas pajisjes me certifikatë sigurie të përshtatshme.

6. Autorizimi i vizitës përmban:

a) Qëllimin dhe arsyen;

b) Nivelin e certifikatës së sigurimit industrial, emrin e kontraktuesit, adresën, numrin e telefonit dhe adresën elektronike të tij;

c) Emrin, datën, vendlindjen dhe shtetësinë e personit, që kryen vizitën;

ç) Vërtetimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimin për aksese të veçanta;

d) Emrat e personave, që do të kontaktohen;

dh) Periudhën e vlefshmërisë së dokumenteve të autorizimit të vizitës.

Në çdo rast, personeli i sigurisë, i autorizuar, i kontraktorit mban protokollin e vizitave.

7. Në vizitat e miratuara më parë, që lidhen me kontratën e klasifikuar, materiali i klasifikuar mund të ekspozohet pa miratimin e autoritetit kontraktor, në rastet kur kontraktuesi e gjen të mbështetur në ligj.

8. Vizitat nga përfaqësues të një pale të tretë bëhen vetëm me miratim paraprak të palëve, të përfshira në kontratën e klasifikuar.

X. RREGULLA TË VEÇANTA

1. Dokumentacioni i grumbulluar për verifikimin e kontraktuesit ruhet pranë DSIK-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore të nxjerrin udhëzime, në zbatim të këtij vendimi.

3. Ngarkohet DSIK-ja për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

4. Vendimi nr.380, datë 31.5.2001 i Këshillit të Ministrave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në fushën industriale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA/INSTITUCIONI

Adresa _____

Tel/fax _____

Nr. _____ Prot .

Kopje nr. _____

Tiranë, më _____

Lënda: Kërkesë për certifikimin e operatorit ekonomik
Drejtuar: z.

Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit
të Informacionit të Klasifikuar
(pranë Këshillit të Ministrave)

Në mbështetje të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar, dhe të vendimit nr. _____, datë _____ “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në fushën industriale”, të Këshillit të Ministrave, lutemi nga ana

Juaj, merrni në shqyrtim pastërtinë e operatorit ekonomik “_____”
me pronar _____

Emri i kompanisë _____
Pronari/pronarët _____

Nr.tel _____
Fax _____
Vendi i themelimit _____
Data e regjistrimit _____
Objekti i aktivitetit _____
Ku e ushtron aktivitetin _____

Për t’u njohur me informacione të klasifikuara “sekret shtetëror” të nivelit:

[] “Konfidencial”
[] “Sekret”
[] “Tepër sekret”

Në mbështetje të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr.____, datë _____ “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në fushën industriale” të Këshillit të Ministrave, kërkojmë që operatori ekonomik, “_____” të pajiset me “certifikatë sigurie industriale”, për t’u njohur me informacion të klasifikuar “sekret shtetëror”.

Lutemi, nga ana Juaj, në bazë të pikës IV/1 të vendimit të mësipërm, merrni në shqyrtim kërkesën e paraqitur.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë, ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Deklaratën e pronarit ose të pronarëve të operatorit ekonomik, ku pranohet që të mblidhen të dhëna dhe të bëhen verifikime ndaj tij.

2. Deklaratën për ruajtjen e sekretit shtetëror.

3. Pyetësori i sigurimit industrial.

Për sa më sipër, jemi në pritje

TITULLARI

(_____)

ANEKSI 2

DEKLARATË

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e _____
i/e vitlindjes _____, lindur në _____ dhe banues/banuese në _____
_____, me kombësi _____ dhe shtetësi _____
aktualisht administrator/drejtuës i operatorit ekonomik _____ me
vullnetin tim të lirë,

DEKLAROJ SE:

- Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në “Pyetësin personal të sigurisë” si dhe në “Pyetësin e sigurisë industriale” për operatorin ekonomik _____, të trajtohen nga autoriteti publik dhe personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllimet e ligjshme në lidhje me kërkesën time për t’u njohur me informacione të klasifikuara “sekret shtetëror”.

- Jam dakord që ndaj meje dhe operatorit ekonomik të aplikohen procedurat e verifikimit nga autoritetet publike, të cilat me aktet normative në fuqi janë të ngarkuara për të kryer një detyrë të tillë.

- Jam i ndërgjegjshëm se çdo deklaram fals ose mungesë e ndonjë fakti të rëndësishëm mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të ndaluar procedurat e verifikimit ndaj meje dhe për të mos u pajisur me “certifikatë sigurie” nga autoriteti përkatës.

- Për sa deklaroj më lart bazohet në nenin 35 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe pika II/2 e vendimit nr.122, datë 15.3.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe dhënien e “certifikatës së sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i

ndryshuar, si dhe vendimit nr.121, datë 2.2.2009 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në fushën industriale” të Këshillit të Ministrave.

_____, më _____ 200_____

DEKLARUESI
(_____)

ANEKSI 3

DEKLARATË

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e
_____ i/e vitlindjes _____, lindur në _____ dhe
banues/banuese në _____
_____, me kombësi _____ dhe shtetësi _____
aktualisht administrator/drejtues i operatorit ekonomik _____
mbështetur në detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi,

DEKLAROJ SE:

- Do të ruaj sipas ligjit dhe me përgjegjësi të plotë informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” që unë dhe operatori ekonomik do të administrojë gjatë realizimit të kontratës së klasifikuar.

- Do të vendos një sistem sigurie në operatorin ekonomik, i cili do të mbulojë të gjitha kërkesat e duhura të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera nënligjore.

- Do të garantoj që statusi i sigurisë së personelit që u kërkohet të kenë njohje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të jetë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligj dhe aktet e tjera nënligjore.

- Do të krijoj të gjitha kushtet për mbikëqyrje e inspektime nga DSIK-ja dhe institucioni shtetëror me të cilin kemi kontraktuar në funksion të masave të marra për të siguruar informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” gjatë gjithë periudhës që mbulon kontrata.

- Do të emëroj oficerin e sigurisë me cilësinë e personit përgjegjës të subjektit tim për të ndjekur e raportuar në mënyrë direkte çështjet e sigurisë së informacionit të klasifikuar te bordi drejtues dhe DSIK-ja.

_____, më _____ 200_____

DEKLARUESI
(_____)

VENDIM
Nr.122, datë 2.2.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË BARAZISË GJINORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij.
 2. Efektet financiare për pagesën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, në shumën prej 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në vit, të përballohet nga fondet e programuara në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
 3. Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË BARAZISË GJINORE

Neni 1
Parimet e veprimtarisë së Këshillit

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit, si dhe në parimet e tjera, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, dhe të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe në ligjin nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Neni 2
Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit

1. Përzgjedhja për anëtarin në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore përfaqësues i shoqërisë civile/organizatës jofitimprurëse, bëhet një herë në katër vjet nga ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore, në përfundim të një procedure konkurrimi të hapur mbështetur në kriteret që vlerësojnë angazhimin e tij/saj në çështjet e barazisë gjinore.

2. Përfaqësuesit/et e qeverisë, të shoqërisë civile/organizatës jofitimprurëse në Këshill emërohen sipas procedurës së përcaktuar në urdhrin e Kryeministrit për krijimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Neni 3
Mandati i anëtarëve të Këshillit

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.

2. Mandati i anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore fillon me aktin e emërimit të tij/saj, nga ministri/ja që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

3. Nëse anëtari/ja i/e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore ka plotësuar mandatin e parë prej 4 vjetësh, ministri/ja, që mbulon çështjet e barazisë gjinore, i drejton një kërkesë drejtuesit/es të/së ministrisë në të cilën kërkon rikonfirmimin e një mandati të dytë për këtë anëtar/e, apo zëvendësimin e tij/saj me një përfaqësues/e të ri/re. Ministri/ja që mbulon çështjet e barazisë gjinore, bën riemërimin ose emërimin me një mandat të ri të anëtarit/es të Këshillit, mbështetur në propozimin e ministrit/es.

4. Ministri/ja që mbulon çështjet e barazisë gjinore, gjatë procedurës së ripërtëritjes së mandateve bën kujdes të shmangë ripërtëritjen në të njëjtën kohë të të gjitha mandateve të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Nëse vërtetohen situata të tilla, atëherë përfaqësuesit e shoqërisë civile do të jenë anëtarët e Këshillit të cilët do të rifitojnë drejtpërdrejt një mandat të ri.

5. Anëtari/es të/së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore i ndërpritet mandati 4-vjeçar, nëse lirohet nga detyra, për shkak të së cilës ai/ajo është anëtar/e i/e Këshillit. Në këtë rast ministri/ja propozon dy përfaqësues të tjerë për në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, duke pasur në konsideratë zbatimin e parimit të përfaqësimit të barabartë, sipas përkatësisë gjinore.

6. Nëse anëtarit/es, përfaqësuesi i organizatës jofitimprurëse në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore i ndërpritet mandati 4-vjeçar, për shkak të lirimit nga detyra, organizata jofitimprurëse do t'i nënshtrohet procedurës, sipas pikës 2 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 4
Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit

Mandati i anëtarit/es të/së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore përfundon:

1. me plotësimin e afatit 4-vjeçar, nuk është ripropozuar për një mandat të ri;

2. pas lirimit nga detyra për shkak të së cilës është emëruar anëtar/e i/e Këshillit;
3. me dorëheqjen e vetë anëtarit/es së Këshillit, për të cilën duhet të njoftojë me shkrim një javë përpara organin që e ka propozuar;
4. për shkaqe shëndetësore të cilat e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen e tij/saj për më shumë se dy mbledhje në vit;
5. me vdekjen e tij/saj.

Neni 5 **Kryetari/ja i/e Këshillit**

1. Kryetari/e i/e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore është ministri/ja që mbulon çështjet e barazisë gjinore.
2. Kryetari/ja i/e Këshillit drejton mbledhjen e tij, diskutimet në të, siguron zbatimin e dispozitave të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
3. Kryetari/ja mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 6 **Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit**

Anëtar/ja i/e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore merr një shpërblim prej 5000 (pesë mijë) lekë, për pjesëmarrje në mbledhje.

Neni 7 **Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjet e Këshillit**

1. Në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore mund të ftohen të marrin pjesë, pa të drejtë vote:
 - a) drejtuesi/ja i/e strukturës për çështjet e barazisë gjinore në ministri;
 - b) përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që merren me çështje të barazisë gjinore;
 - c) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat japin kontribut në fushën e barazisë gjinore;
 - d) ekspertë të administratës publike, në varësi të çështjeve që do të diskutohen;
 - e) nëpunësit që merren me çështjet e barazisë gjinore në ministri dhe organe të qeverisjes vendore;
 - f) ekspertë të çështjeve të barazisë gjinore, si dhe
 - g) ekspertë të tjerë të fushave të ndryshme.
2. Të ftuarit marrin pjesë nëse:
 - a) ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore e vlerëson si të nevojshme dhe të domosdoshme këtë;
 - b) kërkohet paraprakisht nga anëtarët e Këshillit;
 - c) kërkohet nga drejtuesi/ja i/e strukturës për çështjet e barazisë gjinore në ministri;
 - d) kanë paraqitur në mbledhjen e mëparshme një kërkesë për këtë qëllim dhe Këshilli ka marrë vendim për këtë çështje.
3. Gjatë mbledhjes së Këshillit në të cilën marrin pjesë, ata mund të ftohen të japin shpjegime dhe sqarime për çështjet që diskutohen, nëse kjo kërkohet nga anëtarët e Këshillit.

Neni 8 **Rregulli i mbledhjes së Këshillit**

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore mbledhet jo më pak se 2 herë në vit, në varësi të

problematikës që kërkon të shqyrtohet në këtë Këshill.

Neni 9

Thirrja e mbledhjes së Këshillit

1. Thirrja e mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore bëhet nga kryetari, i cili vendos për datën, kohën dhe vendin e mbledhjes së radhës.

2. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje edhe kur kjo kërkohej me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

3. Njoftimi për mbledhjen e radhës bëhet jo më vonë se 15 ditë para nga data kur do të zhvillohet mbledhja.

4. Njoftimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

5. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar/e të Këshillit, 5 ditë para mbledhjes, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.

Neni 10

Rendi i ditës

1. Kryetari i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës duhet të përfshijë:

a) çështje që i janë propozuar atij nga anëtarët e Këshillit me të drejtë vote, nga drejtuesi/ja e strukturës që mbulon çështjet e barazisë gjinore, apo organizatat jofitimprurëse që kanë veprimtari në këtë fushë dhe

b) që janë në kompetencë të Këshillit sipas nenit 12 të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

2. Kërkesa për ta futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 7 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen.

3. Rendi i ditës duhet t’u shpërndahet të gjithë anëtarëve, jo më vonë se 15 ditë para nga data kur do të zhvillohet mbledhja, dhe të paktën 7 ditë para datës së thirrjes të mbledhjes. Bashkëngjitur rendit të ditës anëtarëve u shpërndahen edhe materialet që do të diskutohen në mbledhje.

Neni 11

Kuorumi

1. Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore është e vlefshme kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij.

2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari/ja vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 7 ditë pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme, në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Neni 13

Shumica e nevojshme për të marrë vendime

1. Vendimet për çështjet që diskutohen në Këshill merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe që kanë të drejtën e votës.
2. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit/es është vendimtare.

Neni 14

Forma e votimit

Vendimet në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjimore merren me votim të hapur.

Neni 15

Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje që u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbali mbahet nga sekretariati i Këshillit dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet nga kryetari/ja e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjimore.
3. Në rastet kur vetë Këshilli e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

Neni 16

Përfshirja në procesverbal e votave “kundër”

1. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjimore mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ky Këshill.
2. Në rastet kur vendimet e Këshillit do t'i dërgohen një organi më të lartë të administratës, këto vendime do të shoqërohen me deklaratimet e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjimore.

Neni 17

Sekretariati i Këshillit

1. Për realizimin e funksioneve të Këshillit Kombëtar të Barazisë, sekretariati i Këshillit:
 - a) përgatit ose koordinon hartimin e materialeve, me institucionet dhe strukturat përgjegjëse për çështjet që do të diskutohen në mbledhjen e Këshillit;
 - b) siguron dorëzimin e materialeve tek anëtarët e Këshillit, në afatet e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjimore përbëhet nga tre punonjës të strukturës që mbulon çështjet e barazisë gjimore në ministrinë e kësaj fushe.

VENDIM
Nr.126, datë 2.2.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS POGON, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pogon, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Pogon të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.764, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pogon të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pogon për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pogon

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-29, 31-100	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
101-206	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
207-280	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
281-283	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
626	Prona që përdoren për realizimin e	Në pronësi

	funksiioneve në fushën e shërbimit social	
627-635	Varrezat publike	Në pronësi
636	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
637,638,640,642,644,646,647,649,650,652,653	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
639,641,643,645,648,651,654,655-658 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
675-689	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.127, datë 2.2.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË MALIQ, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Maliq, të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 964 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Maliqit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Maliq

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
6-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
27-29	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
30-25,566-572	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
18-26	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
239-254	Shërbim funeral	Në pronësi
3,140-154,155-159,255,257-272,274-282,285,286,288-291,295-304,309-312,313-317,320-323,324-334,335-409,410-415,416-470,473,475-479,480-485,487,488-492,495,496,504,506,536,564,584,586,592-898	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, troje të zëna, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
52-72,5,94-102,104-105,273,283,287,497-501,505,507,510-523,525,527-530,538,539,541,546,555,556,576,578	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
256,284,292,293,294,308,318,319,471,472,474,486,493,494,502-503,508-509,524,526,531-535,537,540,542-545,547-551,553-554,557-563,565,573,577,579-583,585,587,588,589-591	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
106,162,163,165,167,169,171,173,175,176,178	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
900-912	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
161,164,166,168,170,172,174,177	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.128, datë 2.2.22009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 9 shkurt 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tri) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 11 shkurt 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 13 (trembëdhjetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 9 shkurt 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 11 shkurt 2009, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË
Nr.1008, datë 12.2.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për

shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private (kultura bujqësore dhe drufrutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrëshen-Kalimash”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ju bëjmë me dije se listat dhe vlerësimet janë hartuar në bazë të sasive të sipërfaqeve tokë (truall dhe arë) dhe pasurive të shpronësuara me vendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë dalë lidhur me këtë segment rrugor. Pra të gjithë pronarët që nuk kanë emrat në këto lista, apo nuk janë vlerësuar për të gjitha pasuritë që pretendojnë, nuk rezultojnë në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave që kanë miratuar kërkesën për shpronësimin e sipërfaqeve të tokës (arë + truall), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 73 301 000 (shtatëdhjetë e tre milion e treqind e një mijë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve
Drejtoria Juridike
Sek.Shpronësimeve
LISTA E PRONAREVE QE SHPRONËSOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRESHEN- KALIMASH"

FSHATRAT : BLINISHT,REPS,MASHTERKOR,ZAJS,SHMERI

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas	Sipërfaqja e shpronësimit m²	Kultura bujqësore leke	Drufrutore leke	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Gaspar	Pjeter	Ndoka	2610	93	1579	6000	96000	102000
2	Zef	Preng	Ndoj	2610	102	922	13000	628000	641000
3	Ndue	Preng	Ndoj	2610	103,144,145,146,147	1896		576000	576000
4	Gjon	Preng	Marku	2610	205;206	980	52000	302000	354000
5	Zef	Bib	Tuci	2610	225	2609	52000	378000	430000
6	Ndue	Frrok	Marku	1893	425;422	1062		401000	401000
7	Gjergj	Frrok	Marku	1893	423,420,419	812		209000	209000
8	Mark	Zef	Shyti	1893	418,413,416,415	2939		620000	620000
9	Ndue	Mehill	Gjoka	1221	112/7;112/5	1600		99000	99000
10	Anton	Fran	Zefi	1893	412,411,364,356	1905		295000	295000
11	Gjergj	Zef	Shyti	1893	361;363;358;414/9	2174		856000	856000
12	Pjeter	Zef	Shyti	1893	357;360;365;414/4	1982		673000	673000
13	Pashke	Bardhok	Kaza	1893	337	118		128000	128000
14	Gjet	Mark	Kaza	1893	336	102		140000	140000
15	Pashk	Gjok	Kaza	1893	339	389		250000	250000
16	Pjeter	Zef	Kaza	1893	341;414/6	2043		122000	122000
17	Llesh	Gjok	Kaza	1893	342;335/1	425		39000	39000
18	Dedin	Preng	Koka	1893	333,258/2;414/8	2848		956000	956000
19	Nikoll	Gjok	Kaza	1893	338	944		486000	486000
20	Mark	Ndue	Marfana	1221	59/14	300		259000	259000
21	Mehill	Kol	Gjoka	1221	112/4;86	3524		57000	57000
22	Gjergj	Ndue	Prenga	1221	90/1,112/9	1866		683000	683000
23	Ndue	Pjeter	Prenga	1221	90/2,112/10	1732		709000	709000
24	Nikolin	Pjeter	Prendi	1221	81/4	270		65000	65000
25	Ded	Preng	Prendi	1221	88/6,88/4,78;89/2	5435		623000	623000
26	Fran	Nikoll	Prendi	1221	81/1,83,88/2,88/3,89/1	3212		844000	844000
27	Frrok	Gjet	Fusha	1221	81/3	1502		201000	201000
28	Fran	Nikoll	Shtjefni	2933	157/3	1740		65000	65000
29	Fran	Ndue	Bardhi (Gjeta)	2933	152/11	1143		46000	46000
30	Frrok	Dod	Shtjefni Marku	2933	152/10	750		54000	54000
31	Gjovalin	Llesh	Marku	2933	152/8	2246		63000	63000
32	Pjeter	Nikoll	Lleshi	1893	40,33,30,34,	4610	86000	528000	614000
33	Pashke	Ndue	Marku	2933	151,152/4;157/4,158,	3757		219000	219000
34	Shkurt	Preng	Ndoj	2610	100,101,137,139	2623	18000	467000	485000
35	Aleksander	Mark	Sinani	2610	187,189,186,197	4743	105000	1199000	1304000
36	Hil	Prend	Prenga	2186	284/1;283	2015		341000	341000
37	Mrica	Mark	Lleshi	1893	31,32,29,36	5161	10000	550000	560000
38	Nikoll	Ndue	Gjoka	1893	268,263/2	1693	57000	570000	627000
39	Simon	Pjeter	Lleshi	1893	37,35,43,	1909		958000	958000
40	Dod	Llesh	Ndreca	2610	235	288		173000	173000
41	Nikoll	Llesh	Ndreca	2610	165/3,169,163	1146		677000	677000
42	Gjergj	Bib	Tuci	2610	232	1980		574000	574000
43	Tonin	Preng	Marku	2610	207;202;203	1662		557000	557000
44	Zek	Gjon	Marpepa	2610	168,164,240	133		242000	242000
45	Nikoll	Pjeter	Ndoka	2610	96	4233	24000	156000	180000
46	Gjet	Llesh	Prenga	2610	133,159,160/1	1011		351000	351000
47	Gjon	Llesh	Prenga	2610	157	300		217000	217000
48	Zef	Llesh	Marku	2610	210	183		223000	223000
49	Marie	Frrok	Skana	2610	214/2,183	1971		956000	956000
50	Bardhok	Preng	Ndoj	2610	94	518		117000	117000
51	Gaspar	Preng	Ndoj	2610	95	540	5000	158000	163000
52	Viktor	Ndue	Prenga	2610	152,150/3,150/4,148,154	883		410000	410000
53	Ndue	Nikoll	Ndoj	2610	199;200	2508		1082000	1082000
54	Ded	Kol	Skana	2610	181	300		170000	170000

55	Pjeter	Ndue	Prenga	2610	155;153;149;150/5	1703		542000	542000
56	Gjergj	Kol	Skana	2610	222;180	796	40000	340000	380000
57	Gjovalin	Zef	Skana	2610	218;221	684		168000	168000
58	Ndue	Dod	Kaza	1893	355;414/13	1184		343000	343000
59	Gjok	Llesh	Ndreca	2610	167	62		32000	32000
60	Preng	Gjon	Marpepa	2610	173,241	139		111000	111000
61	Ndrec	Ndue	Lleshi	2186	285;286	336		179000	179000
62	Marte	Mark	Prenga(Bashkepronesi	2610	151, 150/1,143	1238		570000	570000
		TOTALI					468000	24103000	24571000

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Drejtoria Juridike

Sek.Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEG. RRUGOR " RRESHEN - KALIMASH " FSHATI :

THIRRE

Nr .	Pronari			ZK	Nr. pas	Sip.m ² sipas listave	Vlera leke bime arash	Vlera leke drufrutor	Vlera totale leke
	Emr i	Atesia	Mbiem ri						
1	Toni n	Mark	Prendi	3599	243,17	4300		138000	138000
2	Gjin	Gjergj	Pjetri	3599	190	300		330000	330000
3	Llesh	Gjergj	Pjetri	3598	127/1,127/2	2750	108000	386000	494000
4	Gjon	Zef	Pjetri	3599;3598	77/2,196,76 /1	3817		538000	538000
		TOTAL I					108000	1392000	1500000

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Drejtoria Juridike

Sek.Shpronimesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRESHEN -KALIMASH", Fshati:
Bisak

Nr .	Pronari			ZK	Nr. pas.	Sip.m ² Sipas Listave	Vlera leke bime arash	Vlera leke drufrutor	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Bardho k	Dod	Shyti	119 0	11/2,11/3,10	1446	34000	192000	226000
2	Pjeter	Dod	Shyti	119 0	27/1	288		189000	189000
3	Kin	Zef	Prenga	119 0	2,3/2	1646		469000	469000
4	Mehill	Zef	Prenga	119 0	3/3,9/1,9/2	500		261000	261000
5	Pjeter	Dod	Prenga	119 0	4/1	1100		461000	461000
6	Preng	Dod	Prenga	119 0	4/2	880		483000	483000
7	Kol	Zef	Prenga	119 0	27/3	200		191000	191000
8	Gjet	Nikoll	Pershqef a	119 0	60	600		262000	262000
9	Ndue	Gjok	Pershqef a	119 0	47/2,26/2	1701		453000	453000
10	Ndue	Zef	Pershqef a	119 0	47/1,50,49/2,4 6	2766		426000	426000
11	Mirash	Ndue	Pershqef a	119 0	48	773		534000	534000
12	Ndue	Mark	Gjoka	119 0	54/1,55,51,53, 56	1850		863000	863000
13	Zef	Nikoll	Nikolli	119 0	8	900		935000	935000
14	Pal	Mark	Lazri	119 0	54/2	250		290000	290000
15	Gjovali n	Mark	Ndoi	119 0	29/2	423		450000	450000
		TOTA LI					34000	6459000	6493000

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Drejtoria Juridike

Sek.Shpronimesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEG.RRUGOR "RRESHEN - KALIMASH", FSHATRAT:
NDERFUSHE, NDERFANE DHE GZIQ

Nr	PRONARI			ZK	Nr. pas	Sip.m ² sipas listave	Vlera leke bime arash	Vlera leke drufrutor	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Preng	Pjeter	Perleka	2769	19/10	250		127000	127000
2	Dava	Llesh	Perleka	2769	19/9	1094		90000	90000
3	Pashk	Frrok	Nikolli	1713	146/2,1;145/3,2,1;144/1,2;143	8363	16000	823000	839000
4	Nikoll	Mark	Gjoka	2769	267	11523		223000	223000
5	Nikoll	Gjok	Nikolli	1713	146/7,10,12,4,3,9;10,146/14,	5657	120000	676000	796000

6	Ndue	Gjok	Nikolli	1713	148,146/8,146/5,146/6	7256	126000	1044000	1170000
7	Bardhok	Gjon	Perleka	2769	19/6	448		75000	75000
8	Fran	Frrok	Doda	2768	345/23	296		183000	183000
9	Bashkëpronare (Leke Frrok Doda)			2768	345/15	909		191000	191000
10	Pjeter	Ndue	Doda	2768	345/9	5575		163000	163000
11	Gjok	Pjeter	Nikolli	2768	302/4;303/3	6207	17000	830000	847000
12	Nikoll	Kol	Nikolli	2768	302/6;303/25	8888	23000	1415000	1438000
13	Ded	Nikoll	Nikolli	2768	302/3	452	15000	212000	227000
14	Ilirjan	Dod	Doda	2768	345/25	951		126000	126000
		TOTALI					317000	6178000	6495000

REPUBLIKA E SHQIPERË

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Drejtoria Juridike

Sek.Shpronësimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEG.RRUGOR "RRESHEN -KALIMASH", Fshati Shtrungaj

Nr .	Pronari			ZK	Nr. pas	Sip.m ² sipas listave	Vlera leke bime arash	Vlera leke drufrutor	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Pashk	Ded	Nikolli	343 3	59/7	175		160000	160000
2	Bardhok	Pjeter	Pjetri	343 3	54/1,56/2	2080		542000	542000
3	Ded	Gjon	Laska	343 3	2/1	1250		280000	280000
4	Gjon	Ndue	Ndoj	343 3	52,45/2,4 4	4225		1516000	1516000
5	Aleksander	Zef	Marku	343 3	42/1	2375		351000	351000
6	Marte	Preng	Vorfi	343 3	49	300		208000	208000
7	Pashk	Preng	Lleshi	343 3	50.48	1200		423000	423000
8	Dava	Preng	Lleshi	343 3	51/1	1900		410000	410000
9	Ndue	Zef	Zefi	343 3	42/5,45/1	1550		436000	436000
10	Ded	Dod	Nikolli	343 3	59/9,60/3	384		167000	167000
11	Viktor	Dod	Nikolli	343 3	59/11	700	22000	124000	146000
12	Gjin	Nikoll	Nikolli	343 3	59/4,59/1 0	900		227000	227000
13	Viktor	Fran	Pjetri	343 3	55/1	500		144000	144000
14	Ndrec	Ndue	Laska	343 3	2/2,3	2250		301000	301000
15	Fran	Ndue	Cera	343 3	6,7/2	15631		3489000	3489000
16	Gjet	Dod	Nikolli	343 3	59/3,60/4	1525		391000	391000
17	Ndue	Gjon	Pjetri	343 3	7/4	1834		820000	820000
		TOTALI					22000	9989000	10011000

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Drejtoria Juridike

Sek.Shpronesimeve

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEG.RRUGOR " RRESHEN - KALIMASH" FSHATI SANG

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Sip.m ² sipas listave	Kultura bujqesore leke	Drufrutore leke	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Preng	Pjeter	Prenga	3259	113	3736	166000	487000	653000
2	Frrok	Kol	Frroku	3259	118	1409		389000	389000
3	Zef	Preng	Doda	3259	125	1673		278000	278000
4	Ndue	Vorf	Loka	3259	149/1,200,149/ 2	3031		201000	201000
5	Nikoll	Vokerr	Nikolli	3259	121/1,197	803		257000	257000
6	Mark	Ndue	Lleshi	3259	205,157,141	1718		272000	272000
7	Gjet	Vokerr	Nikolli	3259	191,102,114	3400		197000	197000
8	Ndue	Gjok	Doda	3259	120/2	1540		479000	479000
9	Marte	Ndrec	Lleshi	3259	151,152	1929		838000	838000
10	Ndue	Zef	Lleshi	3259	143,139	1630		385000	385000
11	Frrok	Preng	Loka	3259	150	728	5000	183000	188000
12	Gjon	Mark	Lleshi	3259	140,206	800		194000	194000
13	Llesh	Ndue	Lleshi	3259	142	560		202000	202000
14	Fran	Ndue	Lleshi	3259	202,155/1,155/ 2	1020		229000	229000
15	Bib	Ndue	Lleshi	3259	135	1700	21000	291000	312000
16	Ndue	Zef	Pepa	3259	116/1,188	750		327000	327000
17	Gjok	Ndue	Ndoj	3259	162	257		271000	271000
18	Gjergj	Zef	Doda	3259	108/2	447		272000	272000
19	Ded	Ndue	Ndoj	3259	161	151		288000	288000
20	Dila	Zef	Gjoni	3259	119/2	980		153000	153000
21	Preng	Mark	Prenga	3259	104/2	1600		705000	705000
22	Mark	Preng	Prenga	3259	106	908		421000	421000
23	Ndue	Preng	Prenga	3259	105	1333		595000	595000
24	Pal	Preng	Prenga	3259	104/1	94		129000	129000
25	Ded	Nikoll	Prenga	3259	103/1,103/2	1467		230000	230000
26	Fran	Zef	Doda	3259	108/3	323		234000	234000
27	Nikolin	Gjon	Nikolli	3259	115	236		198000	198000
		TOTAL I					192000	8705000	8897000

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

Drejtoria Juridike

Sek.Shpronesimeve

**LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEG. RRUGOR "RRESHEN - KALIMASH",
FSHATI ZALL-XHUXH**

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas	Sip.m ² sipas listave	Vlera leke bime arash	Vlera leke drufrut or	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Mark	Preng	Prenga	3883	64/1	505		133000	133000
2	Zef	Mark	Vokrri	3883	52,51,50 53	6850		119500 0	1195000
3	Frrok	Ndue	Vokrri	3883	37,38,19 5	5167	51000	320000	371000
4	Gjet	Frrok	Gjergji	3883	1	682		133000	133000
5	Zef	Ndue	Biba	3883	183,7	1700		185000	185000
6	Kol	Ndue	Biba	3883	11/1,184	1966		279000	279000
7	Gjon	Gjet	Gjivuka	3883	29	147		78000	78000
8	Nikolin	Zef	Gjaci	3883	15/1,15/ 2,15/4	3480		430000	430000
9	Bib	Ndue	Gjaci	3883	188,18	2260		364000	364000
10	Martin	Ndue	Gjeta	3883	30,191	900	7000	259000	266000
11	Ndue	Llesh	Lleshi	3883	33/1,190	1306		845000	845000
12	Gjon	Ndue	Deda	3883	61,199	1100		503000	503000
13	Marte	Mark	Deda	3883	57	2030		240000	240000

14	Preng	Ndue	Deda	3883	106,217, 59	2058	30000	347000	377000
15	Ndoc	Ded	Deda	3883	60,200	1500	14000	202000	216000
16	Zef	Nikoll	Gjaci	3883	15/5	500		168000	168000
		TOTALI					102000	568100 0	5783000

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
 Drejtoria Juridike
 Sek.Shpronesimeve
 LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA NDERTIMI I SEG. RRUGOR "RRESHEN-KALIMASH", FSHATI:
 KLOS

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas	Sip.m ² sipas listave	Vlera leke bime arash	Vlera leke drufrutor	Vlera totale leke
	Emri	Atesia	Mbiemri						
1	Preng	Gjet	Marku	2162	99/6,98/2	1373	10000	203000	213000
2	Ndue	Gjet	Marku	2162	98/3,99/7	554		166000	166000
3	Preng	Mark	Mena	2162	84/3,84/8	1100		514000	514000
4	Mark	Ndue	Gjoka	2162	70,66/1,69/ 2,68/2,67/2	4526	68000	244000	312000
5	Dritan	Ndue	Gjoka	1600	10/6	2217	55000	256000	311000
6	Pjeter	Ndrec	Mehilli	2162	95/1	100		97000	97000
7	Gjet	Mark	Tuci	2162	88/4,88/9	950	15000	375000	390000
8	Ndue	Mark	Mena	2162	86/1,85	900		499000	499000
9	Pjeter	Preng	Marku	2162	98/1,99/5	379		243000	243000
10	Preng	Pjeter	Marku	2162	99/2	1895	33000	311000	344000
11	Frook	Pal	Margje ci	2162	99/1,100,10 2	2900		743000	743000
12	Mark	Ndue	Nikolli	2162	88/7,88/1	950		703000	703000
13	Pashk	Zef	Tuci	2162	88/3	300		168000	168000
14	Dava	Nikoll	Tuci	2162	84/5,84/12	508		390000	390000
15	Gjin	Zef	Tuci	2162	84/9,84/4	570		356000	356000

16	Gjin(Gjon)	Ndrec	Lleshi	2162	97	950	12000	112000	124000
17	Pjeter	Ndue	Tuci	2162	88/2,88/8	486		307000	307000
18	Gjovalin	Mark	Prenga	2162	87/9;94	750		104000	104000
19	Mark	Zef	Lleshi	2162	88/10	908		276000	276000
20	Kol	Ndue	Lleshi	2162	88/11,98/4, 99/8,88/6	2088		519000	519000
21	Mara	Gjon	Gjoka	2162	69/1;68/1;6 6/2;67/1	2521		393000	393000
22	Preng	Ndue	Kola	1600	10/1	4235		740000	740000
23	Nikoll	Llesh	Prenga	2162	84/2	300		331000	331000
24	Ndue	Pjeter	Marku	2162	99/10	300		327000	327000
25	Mark	Preng	Gjoka	1600	10/3	2429		981000	981000
		TOTALI					193000	9358000	9551000

KËRKESË

Shtetasi Emiljano Muka, i biri i Arbenit dhe i Suzanës, i datëlindjes 26.11.1990, lindur dhe banues në Golem, Kavajë, kërkon shpalljen të zhdukur të babait të tij, Arben Muka, si dhe caktimin e kujdestarisë së pasurive të tij.

KËRKUESI
Emiljano Muka

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 25.2.2009
Doli nga shtypi më 27.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 44 lekë